

Breshëri plumbash në Milot, një i plagosur



12:34 - 13 Janar, 2021



Të shtëna me armë zjarri kanë ndodhur këtë mesditë në Milot, ku raportohet për një të plagosur. Abcnews.al mëson se i plagosur ka mbetur një person rreth 45-vjeçar i identifikuar si Ylli Ibrahim.

Nga të dhënat e para bëhet me dije se dy persona me motor dyshohet se kanë qëlluar mbi 45-vjeçar, i cili ka marrë plagë dhe është dërguar në spitalin ushtarak në Tiranë.

Ibrahimi është qëlluar sapo ka dalë nga lokali në qendër të Milotit. Drejt tij është qëlluar me breshëri, pasi dyshohet se në vendngjarje janë gjetur 30 gëzhoja plumbash.

Lidhur me ngjarjen, policia ka dhënë informacionin zyrtar. Shërbimet e Policisë të D.V.P. Lezhë, të Komisarariatit të Policisë Kurbin dhe FNSH-së po krehin zonën si dhe janë ngritur pika kontrolli me qëllim identifikimin dhe kapjen e autorit/ëve.

Njoftimi i policisë:

Rreth orës 12:10, në Milot, Kurbin, në rrethana ende të paqarta është plagosur me armë zjarri shtetasi Y.I., i cili është transportuar në spital dhe ndodhet nën kujdesin mjekësor.

Menjëherë në vendngjarje kanë shkuar shërbimet e Policisë dhe Grupi hetimor dhe vijon puna për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes.

Shërbimet e Policisë të D.V.P. Lezhë, të Komisarariatit të Policisë Kurbin dhe FNSH-së po krehin zonën si dhe janë ngritur pika kontrolli me qëllim identifikimin dhe kapjen e autorit/ëve.

g.v/abcnews.al

AktualitetMilotPlagosje

Të ngjashme

Aksidenti tragjik me 4 të vdekur, policia jep detajet: Fëmija i tretë drejt spitalit të Traumës

VIDEO/ Dy të maskuar qëllojnë me breshëri drejt “objektivit”, pamje nga atentati në Milot

Dy persona të maskuar i zunë pritë dhe qëlluan 30 plumba, si u plagos 45-vjeçari në Milot



23:53 - 15 Janar, 2021

Kryeziu: Albin Kurtin dhe Vjosa Osmanin i ka bërë bashkë populli

23:50 - 15 Janar, 2021

Në 20 Janar betohet, por a ndihet i sigurt pas trazirave? Joe Biden i qartë

23:35 - 15 Janar, 2021

Kur fillon shpërndarja e 222 milionë eurove në Kosovë?

23:25 - 15 Janar, 2021

Zbulimi, analizë gjaku që sinjalizon herët për kancerin

19:07 - 15 Janar, 2021

Mediu pa pakt, Idrizi i dorëzon PD-së shifrat e 2017, a rrezikon Basha të...

18:45 - 15 Janar, 2021

A do të lejohet të kandidojë në zgjedhje? Më 22 janar vendoset fati i Albin Kurtit

18:28 - 15 Janar, 2021

“ABC” siguron kasetën, pamjet e masakrës së Reçakut, të mërkurën flet...

12:30 - 15 Janar, 2021

“Skuadra gati! Para marsh!” Dy shqiptarët venë në rresht ushtarët grekë,...

ABC NEWS AL
info@abcnews.al
+355 67 400 9040

Rreth nesh

ABC NEWS është i pari televizion në Shqipëri që në ditën e parë të transmetimeve nis me lidhje direkte nga 7 studio lokale ne Shkodër, Durrës, Elbasan, Korçë, fier, Vlorë e Gjirokaster. Për të pasuruar gjeografinë e informacionit së shpejti do të mundesohet edhe studio nga Lezha me transmetime live në cdo kohë. Në faqen zyrtare në internet, abcnews.al do të gjeni portalin më të pasur ballkanik me lidhje në rrjetet më të mëdha sociale facebook, twitter si dhe në një prej websiteve më të fuqishëm në kulturën e internetit YOUTUBE. Transmetimi i ABC news është live 24 ore. NUIS/NIPT K01711004F

Harta e faqes

Aktualitet	Botë
Politikë	Ekonomi
Rajon	Emisione
Sport	Moti

English
Life

